




# SHIPRESË

për kohët e vështirësive

NGA JOYCE MEYER



# **SHIPRESË**

**për kohët e vështirësive**

nga Joyce Meyer

## SHPRESE PËR KOHËT E VËSHTIRËSIVE

Joyce Meyer

Citimet biblike janë marrë nga Bibla, Versioni ABS.  
E drejta e autorit © 2009 Shoqëria Biblike Shqiptare.  
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara  
Përdorur me leje.

Në raste të tjera të përdorimit të citimeve biblike,  
informacioni jepet menjëherë pas përdorimit të tyre.

© 2021 Joyce Meyer Ministries

Joyce Meyer Ministries  
P.O. Box 655  
Fenton, Missouri 63026 [joycemeyer.org](http://joycemeyer.org)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Përveç rasteve të lejuara në ligjin mbi të drejtat e autorit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të shpërndahet, apo të transmetohet në asnjë formë apo mjet, apo të ruhet në një bazë të dhënash ose sistem rikthimi kompjuterik, pa pasur më parë miratimin e shkruar të publikuesit.

Përktheu: Jonida Osmani  
Faqsje: Gjergji Kollumbi

Emri dhe logoja e Joyce Meyer Ministries janë shenja dalluese me të drejta ekskluzive të kësaj shërbese.

Printuar nga: AGSTUDIO.AL

# TABELA E PËRMBAJTJES

- 4 Hyrje
- 7 Plot me shpresë
- 13 Çfarë të bësh kur ndihesh i bllokuar
- 20 Të zgjedhësh një qëndrim shpresues
- 25 Besoji Perëndisë gjatë stuhisë
- 31 Një fillim i ri
- 37 Si të shohësh lart kur ndihesh poshtë
- 44 A je duke kaluar një kohë të vështirë?

## **HYRJE**

**Unë jam shumë e lumtur që ke zgjedhur të lexosh këtë libër.** Për momentin, mund të jesh lënduar në një farë mënyre ose të ndihesh i mbingarkuar nga ajo që po ndodh në jetën tënde. Dhe ndërsa unë nuk i di saktësisht rrethanat e tua, unë e di një gjë me siguri:

**Ti nuk je vetëm — Perëndia të do ty, dhe ne po ashtu.**

Në fakt, e kam shkruar këtë libër për të të inkurajuar dhe për të të mbushur zemrën me shpresë. Unë dua që ti të dish se edhe tani, pikërisht në mes të asaj që po kalon, Perëndia është në anën tënde dhe asgjë nuk është e pamundur me Të (shih Luka1:37). Ai ka një plan të mirë për të ardhmen tënde dhe Ai është duke punuar tashmë në prapa skenë për të të ndihmuar (shih Jeremia 29:11).

Ndoshta një tragjedi e papritur sapo ka ndodhur në jetën tënde dhe nuk je i sigurt se si të ngrihesh dhe të vazhdosh përpara. Ose mbase po vuan nga një çështje mjekësore dhe nuk ke asnjë mundësi për të takuar një mjek. Unë e di se ka kaç shumë njerëz që jetojnë çdo ditë, pa qenë të sigurt se si do të sigurojnë vaktin e tyre të ardhshëm.

Kur ne kalojmë diçka tepër të vështirë, mund të tundohemi të dorëzohemi dhe të heqim dorë. Megjithatë, gjëja e vetme më e rëndësishme që mund të bëjmë është të vendosim besimin tonë tek Zoti dhe të qëndrojmë plot

shpresë. Por çfarë është në të vërtetë shpresa?

Shpresa është pritshmëri plot siguri që diçka e mirë do të ndodhë. Ajo është e lidhur ngushtë me besimin tonë dhe çfarë ne besojmë. Kur ne guxojmë të shpresojmë, jeta jonë mbushet plot e përplot me gëzim dhe paqe.

Armiku dëshiron që ne të jemi pa shpresë. Ai dëshiron të na bindë që gjithçka ka humbur dhe asgjë nuk do të shkojë mirë. Por Perëndia dëshiron që ne të jemi plot shpresë — duke besuar dhe pritur gjëra të mëdha prej Tij. Në fakt Bibla thotë se Ai është “Perëndia i shpresës”, plot mëshirë dhe fillime të reja (shih Romakëve 15:13).

Për shkak të abuzimit seksual, verbal dhe emocional që pësova nga babai im si fëmijë, unë zhvillova një qëndrim të pashpresë. Aq shumë gjëra negative më ndodhën sa fillova të prisja diçka të keqe gjithë kohën, madje edhe pasi u bëra e krishterë.

Sidoqoftë, sinqerisht mund të them se Zoti më ka shndërruar nga të qenit negative dhe pesimiste në dikë që është plot shpresë, duke pritur gjithmonë mirësinë e tij në çdo moment. Pak nga pak, Ai më ndihmoi të zbuloja fuqinë e shpresës dhe çfarë do të thotë kjo për mendimet, fjalët, qëndrimet dhe çdo fushë të jetës sime. Pra, edhe tani kur përballem me rrethana të vështira ose has një pengesë, unë ende vazhdoj të shpresoj, duke e ditur që Zoti do të kthejë gjithçka për të mirën time!

Ndoshta ju keni duruar shumë dhimbje, një zhgënjim ose një pengesë dhe nuk mund të imagjinoni asgjë të mirë. Armiku dëshiron t'ju bindë se gjërat nuk do të ndryshojnë

kurrë. Por Zoti dëshiron që ju të dini se Ai ju do, dhe ju mund t'i besoni Atij se do të veprojë mrekullisht në mes të telasheve tuaja! Pjesa juaj është të mos hiqni kurrë dorë së shpresuari - të prisni mirësinë e Tij të shfaqet në çdo moment.

Këto faqe përfshijnë disa nga mësimet më të mëdha që Perëndia më ka mësuar mua në këtë fushë, mësimet që do të forcojnë besimin tuaj dhe do t'ju ndihmojnë të përballoni jetën me një qëndrim krejtësisht të ri.

Unë shpesh them se një person që qëndron plot shpresë, që vazhdon t'i besojë Fjalës së Perëndisë dhe refuzon të heqë dorë, vërtet nuk mund të mposhtet kurrë. Sepse në mes të stuhive të jetës, ndërsa e vendos besimin tënd tek Ai, Ai mund ta mbushë jetën tënde me paqen dhe gëzimin e Tij të jashtëzakonshëm dhe ta kthejë situatën në të mirën tënde.

Unë nuk e di saktësisht se çfarë ke kaluar në jetën tënde apo se çfarë mund të jesh duke kaluar tani. Por unë e di që Perëndia të do ty jashtëzakonisht shumë, Ai i mban sytë e Tij mbi ty dhe Ai do të vazhdojë të të ndihmojë (shih Romakëve 8:38-39; Psalmi 33:18)

Ai është Perëndia i çdo shprese, dhe Ai është i Vetmi që mund të kthejë kohët më të vështira në diçka madhështore.

- KAPITULLI 1 -

# Plot me Shpresë

**Unë ndonjëherë them se ne jemi brezi "dua ta shoh që ta besoj".** Ne duam ta shohim me sy përpara se të besojmë. Në fakt, shumica prej nesh e kanë të vështirë të besojnë që Perëndia po punon në të mirën tonë nëse nuk shohim të ndodhë diçka para syve tanë natyrorë.

Por Perëndia nuk vepron në këtë mënyrë, Ai punon prapa skene. Ndoshta mund të mos shohësh asgjë që po ndodh, por a beson ti se Perëndia është duke punuar tani në jetën tënde? A beson që Ai ka një plan për të ndihmuar fëmijët e tu, martesën tënde, ose ato gjëra për të cilat je duke u lutur prej vitesh ?

Jeremia 29:11 thotë që Perëndia ka një plan të mirë për jetën tënde, *për t'ju dhënë një të ardhme dhe një shpresë.* Me fjalë të tjera, Perëndia po kërkon një mundësi për të qenë i mirë me ty!

Ndoshta e ke të vështirë ta imagjinosh veten si një person pozitiv, plot besim, plot shpresë. Nëse është kështu, unë e di saktësisht se si ndihesh! Disa njerëz thjesht kanë frikë të shpresojnë për shkak se kanë përjetuar shumë



zhgënjime dhe mendojnë se nuk mund të përballojnë më shumë dhimbje.

Por nuk ka problem, sepse Perëndia është “Perëndia i shpresës”, plot mëshirë dhe fillime të reja (shih Romakëve 15:13). Dhe me Të, nuk është kurrë vonë të fillosh të besosh, të shohësh, të shpresosh dhe të presësh.

### **PRITSHMËRI TË MËDHA...**

Një përkufizim i shpresës është “një pritshmëri e favorshme dhe e sigurtë.”

Unë besoj që shumë herë ne marrim një qëndrim pasiv, duke vendosur thjesht “të presim dhe të shohim” nëse do të ndryshojë diçka apo nëse do të na “shkojë” mirë. Por Perëndia dëshiron që ne të presim me qëllim. Ai dëshiron që ne të presim në mënyrë aktive diçka të mirë.

Ndaj, po pyes: *Çfarë je duke pritur?*

Çfarë sheh në mendjen ose në imagjinatën tënde? Si flet për të ardhmen tënde? Kur zgjohesh në mëngjes, a mendon: *Epo, mendoj se do përpiqem edhe një ditë tjetër*, apo zgjohesh me pritshmërinë që sot mund të jetë dita e çlirimit të situatës tënde?

Është e përshtatshme që kur një grua është shtatzënë, të themi se ajo është “në pritje” të një fëmije. Dhe sa më shumë përparon shtatzënia, aq më shumë ajo pret ditën e lindjes.

Shtatzënitë e mia ishin unike sepse të katër fëmijët e mi i kam mbartur për rreth një muaj pas datës së pritshme të

lindjes. Doktori im më thoshte se isha e vetmja grua që qëndronte shtatzënë po aq gjatë sa një elefant!

Kur afrohej fundi i secilës shtatzëni, unë zgjohesha çdo ditë dhe thoja: "Sot do të jetë dita e lindjes. Duhet të jetë". I kisha të gjitha valixhet e mia të paketuara dhe gati. Vazhdimisht kontrolloja çdo gjë dhe sigurohesha nëse gjërat ishin në rregull, e sigurt që bebi im mund të vinte në çdo moment. Sa herë ndjeja një sëmbim, mendoja: *Ja erdhi! Është duke ardhur!*

Pikërisht kështu Zoti dëshiron që ti të jesh me Të! Ai ka një plan të jashtëzakonshëm për jetën tënde, dhe Ai dëshiron që ti të presësh gjërat e mira që janë afër.

Shpresa thotë: "Gjërat mund të kenë qenë në këtë mënyrë për një kohë të gjatë, por Perëndia është Perëndia i së pamundurës, dhe gjërat mund të ndryshojnë".

## **A JENI ROBËR TË SHPRESËS?**

Ashtu siç e përmenda, unë isha personi më negativ që njihja. Përfundimisht isha tipi i personit që e shihte gotën gjysmë bosh. Në çdo situatë shihja anën negative.

Kjo shpjegon pse unë isha kaq e mjerë. Dyshimi dhe negativiteti na ulin poshtë, por shpresa çliron gëzim!

Shpresë do të thotë të kesh një mendësi apo qëndrim pozitiv. Personat shpresues refuzojnë në mënyrë absolute të jenë negativ në çfarëdo mënyre. Megjithëse ata i kuptojnë dhe përballen me stuhi në jetën e tyre, ata mbeten plot shpresë në mendime, qëndrim dhe bisedë.

Shumë herë, mendoj se ngecim në kurthin e pritjes derisa të ndjehemi optimistë ose shpresues. Por shpresa është një vendim për të qenë pozitiv dhe nuk është jetesë sipas ndjenjave. E vërteta është që kur ne marrim një vendim solid për të menduar pozitivisht, mendime plot shpresë, ndjenjat tona do të jenë të qëndrueshme.

Unë e dua shumë vargun tek Zakaria 9:12. Zoti thotë, *Kthehuni në fortesë [e sigurisë dhe begatisë], o ju robër të shpresës! Pikërisht sot unë deklaroj se do të të jap dyfishin.*

Çfarë do të thotë të bëhesh "rob i shpresës"? Do të thotë që pavarësisht se çfarë ndodh në jetët tona, ne refuzojmë të ndalojmë së shpresuari dhe së besuari në aftësinë e Perëndisë për t'ia dalë mbanë.

Kur ju bëheni robër të shpresës, armiku nuk di se çfarë të bëjë. Ai mund të vijë kundër jush me mendime negative, por ai nuk ka asnjë fuqi t'ju lëndojë kur jeni të vendosur që vazhdimisht të vendosni të gjithë besimin tuaj tek Perëndia.

Perëndia dëshiron t'ju bekojë dhe t'ju japë dyfishin për dhimbjen e së kaluarës dhe për gjërat që kanë humbur (shih Isaia 61:7). Dhe pjesa jonë bën gjithë ndryshimin. Pjesa jonë është të besojmë dhe të shpresojmë.

## **ËSHTË KOHA TË HEDHIM SPIRANCËN**

Hebrenjve 6:19 thotë, *[Tani] kjo shpresë që ne kemi është si një spirancë e sigurt dhe e patundur për shpirtin [nuk mund të rrëshqasë dhe as të prishet nëse dikush ecën në të]... (AMPC)*

Le ta analizojmë këtë varg. Unë mendoj, se të gjithë ne e dimë se çfarë është një spirancë. Kur dëshirojmë që një anije të qëndrojë në një vend, ne hedhim spirancën, dhe kjo e lejon atë të lëvizë pa u larguar.

Vargu thotë që shpresa është "spiranca e shpirtit". Shpirti ynë është mendja jonë, vullneti dhe emocionet tona. Shpirti ynë na tregon çfarë mendojmë, çfarë dëshirojmë dhe çfarë ndjejmë.

Pra, çfarë do të thotë e gjithë kjo? Kjo do të thotë që kur çdo gjë duket e zyrtë, kur duket sikur asgjë nuk ka kuptim, dhe ndihemi sikur premtimet e Zotit nuk do të vijnë kurrë në jetën tonë, shpresa është spiranca që na tërheq dhe na thotë: "Prit! Premtimet do të ndodhin!"

Por le ta shohim këtë edhe pak më tej. Hebrejve 6:19 thotë që shpresa është spiranca jonë dhe që...*[ nuk mund të rrëshqasë dhe as të prishet nëse dikush ecën në të]...*

Shpresa është spiranca jonë dhe është pikërisht ajo që na bën të "hedhim hapa". Disa njerëz nuk po i përjetojnë premtimet dhe fuqinë e Perëndisë thjesht sepse nuk po hedhin hapa me besim. Janë këto hapa besimi që i vënë në veprim premtimet e Perëndisë!

Më lejoni t'ju jap një shembull. Për rreth 40 vjet, unë kam udhëtuar nëpër botë dhe kam dhënë mësim nga Fjala e Perëndisë. Por sërish ka raste përpara një konference kur unë nuk ndihem e vajosur, e kualifikuar ose e përgatitur për të bërë atë që jam duke bërë.

Përpara se të ec mbi skenë, mendoj: *Mirë, Perëndi,*

*shpresoj shumë që Ti do të shfaqesh, përndryshe do të jem në telash të madh. Më pas, kur hedh hapat për të bërë atë që unë besoj se Ai më ka kërkuar të bëj, Perëndia gjithmonë vepron dhe më ndihmon të jap mesazhin tim. Asnjëherë Ai nuk më ka braktisur!*

Për shumë nga ju, Perëndia po pret që ju të hidhni hapat në spirancën e shpresës. Ai thjesht po pret për ju që të bëni pjesën tuaj, në mënyrë që ai të shfaqet në jetën tuaj dhe të bëjë gjëra të mrekullueshme.

Mos i lejoni rrethanat e jetës t'ju lëkundin. Hidhni spirancën tuaj dhe ecni në themelin e sigurt të shpresës. Sepse kur e vendosni besimin tuaj tek Perëndia, *nuk do të zhgënjeheni..*

- KAPITULLI 2 -

# Çfarë të Bësh Kur Ndiresh i Bllokuar

**Je ndjerë ndonjëherë i bllokuar?** A ke qenë ndonjëherë në jetën tënde në një vend që dukej si një rrugë pa krye, sikur të mos kishe më asnjë mundësi?

Unë kam qenë shumë herë, dhe jam e sigurt që shumë njerëz kanë qenë gjithashtu. Por jam shumë mirënjohëse që përgjatë viteve Perëndia më mësoi që edhe nëse bllokohem, nuk ka asnjë situatë të vështirë që ai nuk mund ta zgjidhë!

Le të fillojmë duke parë historinë e Jozefit në librin e Zanafillës (shih Zanafilla 37-50). Bibla thotë se ai ishte i preferuari i dymbëdhjetë djemve të babait të tij dhe vëllezërit e tij ishin shumë xhelozë për të për shkak të kësaj.

Një ditë Jozefi tregoi një ëndërr që kishte parë me vëllezërit e tij. Në ëndrrën e tij, të gjithë po përkuleshin para tij. Siç mund ta imagjinoni, ata nuk u ndjenë mirë!

Si rezultat, vëllezërit u mblodhën për të vendosur se si të hiqnin qafe Jozefin. Fillimisht e hodhën në një pus për ta

lënë aty të vdiste. Por më vonë ata vendosën ta shesin atë si skllav te një karvan tregtarësh ismaelitë. Më pas ata hartuan një plan për të bindur babanë e tyre për vdekjen e Jozefit!

Siç mund ta dish, kjo histori përfundon triumfalisht. Jozefi bëhet i dyti në komandë pas Faraonit, përfundimisht ribashkohet me familjen e tij dhe falet gjithçka.

Ajo që i ndodhi Jozefit është një provë që pavarësisht se çfarë kalon në jetë, ka gjithmonë shpresë. Ti mund të përmbushësh qëllimin e Perëndisë për ty sepse gjithçka është e mundur me Perëndinë!

Por pjesa e historisë së tij ku vërtet duhet të përqendrohemi është ajo që ndodhi midis pusit dhe pallatit. Jeta e Jozefit mori disa kthesa gjatë asaj kohe. Por një atribut i karakterit të tij që e solli në këtë fund fitimtar ishte këmbëngulja. Për shkak të besimit të Jozefit te Perëndia, ai nuk u dorëzua kurrë!

## **TË HEQËSH DORË NUK ËSHTË NJË OPSION**

Në jetën tonë, ne mund të biem në një pus herë pas herë. Mund të jetë një pus sëmundjeje, mungesë financiare, çështje marrëdhëniesh ose probleme të tjera. Kurdo që të ndodhë kjo, ti duhet të jesh i vendosur që sido që të jetë situata jote, ti nuk do të heqësh dorë.

Mbani mend gjithmonë, se në mënyrë që të kemi një dëshmi të mirë të asaj që Perëndia ka bërë, së pari ne duhet të kalojmë provat. Jezusi madje na tha:

*...Në botë do të keni shtrëngim, por merrni zemër [merrni kurajo; jini të sigurt, të patrembur], unë e kam mundur botën. [Unë e kam privuar atë nga fuqia për t'ju dëmtuar dhe e kam pushtuar për ju] (Gjoni 16:33).*

Është e pashmangshme, do të kalosh gjëra të vështira. Ndonjëherë mund të ndihesh sikur je gati të heqësh dorë. Por nëse qëndron dhe i beson Perëndisë, Ai mund të të restaurojë. Ai mund të marrë të gjitha të këqijat dhe të bëjë diçka të mirë prej tyre (shih Romakëve 8:28).

Thuhet se Winston Churchill mbajti fjalimin e mëposhtëm para të diplomuarve në shkollën Harrow në 1941:

*"Kurrë, kurrë, kurrë, kurrë, kurrë mos u dorëzoni! Në asgjë të madhe apo të vogël, të rëndësishme apo të parëndësishme, mos hiqni dorë kurrë!"*

Unë nuk e di nëse kjo ishte e vetmja gjë që ai tha, por besoj që Fryma e Shenjtë po e flet këtë gjë për shumë prej nesh sot, "Mos hiq dorë, sepse Perëndia ka përgatitur shumë gjëra për jetën tënde!"

Është shumë e lehtë të duash të dorëzohesh kur gjërat vështirësohen. Ndonjëherë njerëzit bllokohen dhe nuk dinë se si të gjejnë zgjidhje, ndaj mendojnë që të heqësh dorë është më e lehtë.

Ata mund të ndihen sikur nuk janë mjaftueshëm të zgjuar apo të talentuar; ndoshta diçka traumatike u ka ndodhur atyre; ose ata mund të kenë dështuar në diçka ose kanë bërë gabime të tmerrshme në të shkuarën.



Por Fryma e Shenjtë na jep forcën dhe aftësinë për të këmbëngulur, për të vazhduar dhe për të shkuar drejt fitores sonë, edhe nëse gjërat nuk shkojnë ashtu siç kemi planifikuar.

Dështim nuk do të thotë se nuk ka më asnjë mundësi. Ti mund të mësosh nga gabimet e së shkuarës. Kam kuptuar që historia është një mësues i mirë! Kur gjithçka tjetër dështon, përpiku përsëri. Në fund, do të mësosh se çfarë funksionon dhe çfarë jo dhe do të dalësh që aty. Ti mund ta kthesh pengesën tënde në një mundësi për t'u rritur dhe maturuar më shumë frymërisht.

Perëndia dëshiron që ne të jetojmë një jetë të mirë, sidoqoftë besimi dhe këmbëngulja janë një domosdoshmëri. Fryma e Shenjtë do të na udhëheqë në hapa besimi për planet e mira që Perëndia ka për secilin prej nesh. Pjesa jonë është t'i ndërmarim ato hapa...*dhe të mos dorëzohemi kurrë!*

## **ÇFARË TË BËSH KUR JE I LËNDUAR**

Perspektiva jote kur je në "pus" mund të bëjë gjithashtu një ndryshim të madh.

Mbaj mend, është një kohë testimi...një kohë kur karakteri yt është duke u zhvilluar. Këtë periudhë unë ndonjëherë e quaj "vitet e heshtjes" sepse është një kohë kur ti mund të ndihesh sikur asgjë nuk po ndodh në jetën tënde.

Ose ndoshta je duke kaluar dhimbje dhe shqetësime të mëdha, dhe ndihesh sikur Perëndia nuk po bën asgjë për këtë.

Por është tepër e rëndësishme për ty që t'i besosh Atij gjatë kësaj kohe, sepse Ai është duke punuar në zemrën tënde për të të bërë më shumë të ngjashëm me Krishtin.

### **Pra, çfarë duhet të bësh kur bllokohesh në pus?**

- *Mos u dorëzo!* Lufto tundimin e të menduarit që nuk ka asnjë zgjidhje për situatën tënde. Jezusi është Rruga. Kjo është koha jote për t'u afruar më shumë me Të dhe ta ndjekësh.
- *Shmang fajësimin e Perëndisë ose mendimin që Ai po të ndëshkon ty për ndonjë mëkat.* Ai vetëm po e përdor situatën për të punuar në jetën tënde. Dhe ndërsa jo gjithmonë do të ndihesh mirë, qëllimi i Tij do të jetë gjithmonë për të mirën tënde.
- *Bëj atë që është e drejtë edhe kur lëndohesh, kur nuk ndihesh mirë ose kur të tjerët të trajtojnë keq.* Bëj diçka të mirë për sa më shumë njerëz të mundesh sa më shpesh të mundesh.
- *Mos u tërhiq dhe mos e izolo veten nga të tjerët.* Mbaj mend, ti mund të jesh për të ardhur keq ose i fuqishëm, por nuk mund të jesh të dyja! Shumë herë, Perëndia mund të përdorë të tjerët për të të inkurajuar në këtë kohë.
- *Mbaje fjalën dhe ndero përkushtimet e tua.* Kjo është një kohë për ndërtimin e karakterit, dhe ti po përgatitesh të zësh vendin tënd "në pallat".
- *Mos ndalo së besuari...mos hiq dorë nga shpresa që Perëndia mund të përmirësojë situatën tënde!*

## SHKUNDJE

Ti mund ta kesh dëgjuar historinë e gomarit që ra brenda në një pus.

Kur e pa atë që ndodhi, padroni i tij u mendua pak dhe vendosi që pusi ishte shumë i thellë dhe gomari ishte shumë i vjetër, ndaj vendosi ta varroste atë në pus.

Ai thirri disa miq dhe fqinjë për ta ndihmuar dhe ata filluan të hidhnin dhe brenda në pus.

Në fillim gomari qau, padyshim ishte i tmerruar për situatën e tij. Më vonë, padroni i tij vuri re se ai nuk po lëvizte më dhe mendoj që ndoshta gomari kishte ngordhur. Por gomari nuk kishte ngordhur.

Kur padroni vështroi poshtë në pus, pa që sa herë dheu binte në kurrizin e tij, gomari shkundej nga dheu, hidhte hapa mbi të duke u ngjitur më lart. Kështu vazhduan për orë të tëra, derisa, më në fund, gomari kishte mjaftueshëm dhe për të dalë jashtë pusit!

Ne mund të mësojmë diçka nga ai gomar. Jeta do të na hedhë "dhe" herë pas here. Mund të jetë në marrëdhëniet, financat ose shëndetin tonë. Por kjo është një kohë për të mësuar se si të ndjekim drejtimin e Frymës së Shenjtë. Ai do të të tregojë se si të shkundësh papastërtitë dhe të ngrihesh lart, duke të dhënë pamje nga gjërat e mira që do të vijnë në çdo hap që bën nga pusi yt drejt pallatin tënd!

Do të ketë gjithmonë pengesa që duhen kapërcyer.

Do të ketë gjithmonë “çështje” që duhen kaluar. Por gjithashtu do të ketë tejkalime, shanse të dyta dhe fillime të reja.

Nuk është kurrë shumë vonë, vetëm mos u dorëzo! Ndërsa ti bën pjesën tënde dhe bën atë që mundesh, ndërsa mbahesh tek shpresa, ec përpara dhe refuzo të heqësh dorë nga Perëndia. Ai do të jetë besnik për të bërë atë që ti nuk mundesh.

Kështu që, nëse je bllokuar dhe nuk di çfarë të bësh, mos hiq dorë së shpresuari, sepse je në pozicionin e përsosur për një fillim të freskët.

- KAPITULLI 3 -

# Të Zgjedhësh Një Qëndrim Shpresues

**Për shkak se isha abuzuar që kur isha vajzë e vogël,** zhvillova një frikë të paqartë se diçka e keqe do të ndodhte gjithmonë. Ti mund ta kuptosh atë që po them.

Aq shumë gjëra të këqija më ndodhën sa që arrita në pikën ku prisja gjithmonë të ndodhte diçka e keqe, edhe pse isha e krishterë.

Më kujtohet mëngjesi kur u luta dhe e pyeta Perëndinë: “Çfarë është kjo? Pse ndihem gjithmonë në këtë mënyrë?”

Perëndia i foli zemrës time dhe më tha: “Janë parandjenja të liga.” Unë nuk e kisha dëgjuar kurrë më parë këtë term, por disa ditë më vonë gjeta vargun tek Fjalët e urta 15:5, që thotë:

*Të gjitha ditët e të varfrit janë të këqija [nga mendimet e shqetësuarat dhe parandjenjat], por për një zemër të kënaqur ka festë përherë [pavarësisht rrethanave].*

Të gjithë do të përballemi me periudha të vështira në jetë, dhe kur kjo ndodh, është e lehtë të kemi frikë nga e ardhmja dhe të kemi mendime dhe parandjenja plot

ankth. Por ne duhet të arrijmë në pikën ku të mësojmë të jemi dakord me Perëndinë dhe me Fjalën e Tij sa herë që telashet vijnë.

Ne mund ta çlirojmë besimin tonë, duke thënë: “Unë e di që Perëndia më do mua. Ai do të kujdeset për mua. Unë besoj që ai do të më japë hir dhe forcë për të bërë çfarë duhet të bëj, dhe diçka e mirë do të vijë si rezultat.”

### **MOS U TREMB!**

Perëndia kurrë nuk synon që ne të jemi të pakënaqur ose të kemi “një ditë të tmerrshme,” edhe kur gjërat nuk shkojnë sipas planit tonë. Ai dëshiron që ne të presim gjëra të mira dhe të qëndrojmë plot me shpresë, pavarësisht rrethanave tona.

Këtu janë dy fjalë që do të të ndihmojnë për këtë: *Mos u tremb*.

Çfarë është frika? Frika është thjesht pritja e një përvoje të pakëndshme, është plotësisht e kundërta e shpresës.

Pa e kuptuar fare, mendoj se shumë njerëz i përjetojnë të gjitha aktivitetet e tyre të përditshme me frikë: kanë frikën e të shkuarit në punë, të ngecurit në trafik, të larjes së enëve, të larjes së rrobave, të kositjes së barit, të përgatitjes së darkës e kështu me radhë.

Megjithatë, frika mund të vjedhë gëzimin tonë dhe të na shkatërrojë ditën. Frika mund të na lerë pa shpresë. Përkundrazi, unë të inkurajoj të ndalosh së qenuri i trishtuar për gjërat ndaj të cilave nuk mund të bësh asgjë. Zgjidh të qëndrosh i lumtur dhe lejo Perëndinë të kujdeset për to!

Në çdo situatë, ne duhet të kemi një qëndrim që thotë: "Unë mund të bëj gjithçka që duhet të bëj dhe nuk do të ndaloj së shijuari jetën time, pavarësisht se çfarë ndodh. Nuk e kam planifikuar këtë gjë, por e di që Zoti mund të bëjë gjithçka për të mirën time."

Tani, unë nuk po them se kjo do t'i largojë gjithmonë problemet. Megjithatë, të zgjedhësh të mos kesh frikë do ta bëjë me siguri jetën tënde më të mirë!

### **GJEJ GËZIM NË GJËRAT E VOGLA**

Të kesh një jetë fitimtare nuk ka të bëjë vetëm me gjërat "e mëdha" të jetës, por fillon me gjërat e vogla. Zoti dëshiron që ne të jemi në gjendje të kemi sukses dhe gëzim në çdo fushë të jetës tonë, dhe të mundësh frikën është një pjesë kryesore. Zgjedhja jonë për të pasur një qëndrim pozitiv dhe shpresues, mund të bëjë ndryshimin në të vërtetë!

Sigurisht, do të ketë disa gjëra në jetë që janë më të vështira ose më pak të gëzueshme; por sidoqoftë, ato nuk duhet të na bëjnë të ndihemi të mjerueshëm ose të shkatërrojnë jetën tonë. Zgjedhja varet vërtetë nga ne dhe nga qëndrimi që ne zgjedhim të kemi.

Është e habitshme se si mund të ndiejmë keqardhje për veten tonë dhe më pas lejojmë që qëndrimi ynë të shkatërrojë një ditë krejtësisht të mirë për veten dhe të tjerët. Më besoni, kam qenë mjaft e mirë në luajtjen e "martires" kur bëhej fjalë për të bërë punët e shtëpisë.

Shpesh ecja nëpër shtëpi me zhurmë, duke mërmëritur gjëra të tilla si: "Epo, të gjithë këtu presin që unë të

bëj gjithçka. Deivi del dhe luan golf dhe fëmijët bëjnë rrëmujë. Unë thjesht gatuaj ushqimet e tyre, pastroj enët e tyre dhe laj rrobat e tyre. Dua të di se kush kujdeset për mua!”

E vërteta ishte, se askush nuk po më detyronte t’i bëja ato gjëra. Unë zgjedh t’i bëj ato sepse e dua familjen time. Sidoqoftë, rrallë kënaqesha vetë sepse isha e vendosur të mbaja një qëndrim negativ.

Tingëllon si diçka e njohur? Situata jote mund të mos ketë të bëjë me punët e shtëpisë, por të gjithë jemi të tunduar të ndihemi keq për veten dhe të kemi frikë nga diçka herë pas here.

Edhe kur na ndodhin gjëra të këqija ose të papërshtatshme, ne mund të zgjedhim të reagojmë në një mënyrë pozitive. Kur e bëjmë këtë, ne jemi dakord me Zotin, sepse Zoti është gjithmonë pozitiv.

## **PËRQENDROHU TEK GJËRAT POZITIVE**

Unë shpesh i inkurajoj njerëzit të luajnë “Lojën e Gëzueshme”. Çfarë është ajo? Kur përballeni me një situatë negative, zgjidhni me qëllim të shihni të mirat e mundshme!

Për shembull, nëse ngecni në trafik, thoni: “Unë po lëviz ngadalë dhe po bëhem vonë, por ndoshta Zoti po më mbron nga një aksident që mund të më kishte ndodhur nëse do të ecja më shpejt.”

Kjo funksionon për çdo situatë, të madhe ose të vogël. Edhe nëse është diçka po aq e rëndësishme sa humbja e



një pune, ju mund të zgjidhni ta zhvendosni fokusin tuaj në gjërat pozitive dhe të thoni: "Mund të jem pa punë, por tani kam një mundësi të shoh Perëndinë që siguron për mua një punë më të mirë se sa ajo që kisha më parë!"

*Bibla thotë: Prandaj Zoti do të presë për t'ju dhënë hir, pastaj ai do të lartësohet, sepse pati mëshirë për ju, sepse Zoti është një Perëndi i drejtësisë. Lum të gjithë ata që kanë shpresë tek ai!*

(Isaia 30:18)

Çfarëdo lloj vështirësie që ju sjell jeta, Perëndia ka një plan për ta kthyer atë për mirë, një plan të mbushur me shpresë dhe gjëra të mira. Të inkurajoj të jesh dakord me Të.

Mbaj çdo ditë një qëndrim pozitiv, plot shpresë dhe zgjidh të mos trembesh. Ndërsa e bën këtë, unë besoj se do të fillosh të gjesh gëzimin në çdo pjesë të jetës tënde.

- KAPITULLI 4 -

## **Besoji Perëndisë Gjatë Stuhisë**

**Me kalimin e viteve, kam mësuar se është një gjë t'i besosh Perëndisë për diçka, që të ndryshojë diçka ose dikë në jetën tënde, por është plotësisht tjetër gjë t'i besosh Perëndisë përmes vështirësive.**

Unë marr shumë ngushëllim nga Isaia 43:2-3. Vargu thotë: *Kur të kalosh përmes ujërave, unë do të jem me ty, ose të kalosh lumenjtë, nuk do të të mbytin; kur të ecësh nëpër zjarr, nuk do të digjesh dhe flaka nuk do të të përpijë. Sepse unë jam Zoti, Perëndia yt ....*

Kur të jesh duke kaluar kohë të vështira, është kaq e rëndësishme të mbash mend se Perëndia është me ty dhe mund të besosh se Ai do të të ndihmojë t'i kalosh ato.

Për shembull, mund të jetë e vështirë të qëndrosh në besim kur rrethanat e tua nuk kanë kuptim ose jeta është e padrejtë. Është veçanërisht e vështirë kur ndihesh sikur po bën atë që duhet të bësh dhe nuk po merr rezultatin e duhur.

Ose si mendon për këtë: ti sheh dikë që nuk po bën gjënë e duhur, por në dukje ai po merr një rezultat më të mirë se ty! Do të ketë raste në jetën tonë kur gjithçka do të duket sikur po lëkundet dhe asgjë nuk është e sigurt, dhe e vetmja përgjigje e vërtetë është t'i besojmë Perëndisë dhe të vazhdojmë t'i besojmë Atij.

Kam mësuar gjithashtu nga përvoja se Perëndia do t'i përdorë këto kohë për të mirën tonë. Kur jeta duket e paqëndrueshme, Ai do të përdorë rrethanat tona për të na ndihmuar të afrohemi më pranë Tij dhe të kapemi fort pas shkëmbit të shpëtimit tonë, Jezus Krishtit, i cili nuk mund të lëvizet ose të lëkundet! (Shih Psalmi 62:2, 6).

### **“TË RRITESH” GJATË KOHËVE TË VËSHTIRA**

Kjo mund të tingëllojë qesharake, por unë kam arritur në pikën ku besoj se sprovat dhe vështirësitë mund të jenë disa nga miqtë tanë më të mirë. Pse? Sepse Zoti i përdor ato për të na mësuar, për të na stërvitur dhe për të na ndihmuar të rritemi në mënyra që nuk mundemi vetë.

Në fakt, Jakobit 1:2-3 na thotë: *Ta quani gëzim të madh, o vëllezër të mi, kur bini në tundime të ndryshme, duke e ditur se sprova e besimit tuaj sjell durim.*

Sprovat dhe vuajtjet nuk e kanë origjinën nga Zoti, por Ai do t'i përdorë ato për të na bërë më të fortë dhe për të na ndihmuar të gëzojmë një jetë më paqësore, të qëndrueshme dhe më të plotë.

Kohët e vështirësive në jetë bëjnë që ne të zhvillohemi në personin që duam të bëhemi. Kur ne përballemi me një situatë që është jashtë kontrollit tonë, na ndihmon të

vendosim varësinë tonë të plotë tek Ai, duke e ditur që ne nuk mund t'i zgjidhim vetë të gjitha problemet tona.

Zoti dëshiron që ne të vijmë tek Ai për t'u forcuar dhe për të arritur në pikën ku dëshirojmë të jemi të qëndrueshëm edhe kur përballemi me sprovat e jetës. Ai dëshiron që ne të kemi gëzim dhe kënaqësi në të, edhe kur rrethanat tona nuk janë të përsosura. (shih Nehemia 8:10).

Ashtu siç diamantet marrin formë nën një presion të madh, Perëndia shpesh përdor vështirësitë në jetën tonë për të na bërë të përlurur, për t'u zhvilluar në karakterin tonë, për t'u transformuar në imazhin e Tij dhe të na përgatisë për gjërat e mira që Ai ka për të ardhmen tonë.

### **SPROVAT NA NDIHMOJNË TË BESOJMË**

Ka liri të jashtëzakonshme për t'i besuar Perëndisë. Kur diçka nuk po shkon siç duhet, në vend që të mërzhitemi ose ofendohemi, mund të besojmë se Ai ka një plan që është më i mirë se i yni dhe në fund do ta zgjidhë situatën për të mirën tonë (shih Romakëve 8:28).

Ne duhet ta kuptojmë këtë sepse ndonjëherë kur jemi në mes të telasheve, ne mund të zemërohemi me Perëndinë ose me njerëz të tjerë që janë të bekuar. Ne mund të kemi një qëndrim vetë-drejtësie që thotë: "Unë jam një i krishterë më i mirë se sa ti. Unë i meritoj ato bekime"

Për shembull, ndoshta ti dëshiron një promovim në punë, por dikush tjetër e merr atë. *Çfarë duhet të bësh?*

Mund të ofendohesh dhe të lëndosh vërtet veten shpirtërisht. Ose mund t'i besosh Perëndisë dhe të

thuash: "Zot, nëse ti më do këtu tani, atëherë unë do t'i shërbej shefit tim me një buzëqeshje në fytyrën time. Dhe unë e di nëse do të më vendosësh diku tjetër, ti mund ta bësh në kohën tënde të përsosur."

Kam mësuar se Zoti është më i zgjuar se ne! Ndonjëherë Ai nuk shpejton të na japë atë që duam, sepse Ai ka një qëllim tjetër në mendje, diçka më të mirë nga ajo që mund të kishim imagjinuar.

Për shembull, shumë herë Zoti më ka lejuar t'i mësoj gjërat në rrugën e vështirë. Ndonjëherë ka qenë jashtëzakonisht e vështirë, veçanërisht kur shihja njerëzit e tjerë të merrnin përparime në të njëjtat fusha më shpejt.

Por kur Zoti më lejon të eci në këtë rrugë, Ai dëshiron që unë të përfetoj dhe të kuptoj se çfarë po kalojnë njerëzit e tjerë, në mënyrë që të mund të lidhem me dhimbjen e tyre dhe t'i ndihmoj ata ta kalojnë atë me sukses.

Nëse nuk do të ishin kohët e vështira në jetën time, rrethanat që Zoti përdori për të më ndihmuar të rritesha dhe të ndryshoja, sigurisht që nuk do të isha në gjendje të ndihmoja njerëz sot.

Zoti nuk na premtoi kurrë një jetë pa telashe, por Ai premtoi që nuk do të na lërë kurrë dhe nuk do të na braktisë (shih Hebrenjve 13:5). Në kohët e vështirësive, ne mund të ngushëllohemi duke ditur që Ai na do jashtëzakonisht shumë dhe tashmë e ka një plan për të na ndihmuar.

## PERËNDIA ËSHTË ME TY NË ÇDO SITUATË

Dëshiroj të të inkurajoj, të marrësh një vendim të patundur për t'i besuar Perëndisë çdo pjesë të jetës tënde. Kur goditesh nga stuhitë e jetës ose përjeton gjëra që nuk i kupton, atëherë duhet të zgjedhësh të vazhdosh t'i besosh Atij – pavarësisht se çfarë mendon apo ndjen, dhe pavarësisht se si duken rrethanat e tua.

Dhe ndërsa i beson Perëndisë gjatë gjithë vështirësisë, Ai do të të japë diçka të qëndrueshme, *Ai do të të japë më shumë nga Vetja.*

A po kalon diçka të vështirë sot? A ka ndonjë provë që të kërcënon? Nëse po, të inkurajoj të ulesh një moment tani dhe të lutesh.

***“Zot, të falënderoj që je gjithmonë me mua, në kohë të mira dhe gjithashtu kur jeta bëhet e vështirë. Të lutem më ndihmo të afrohem me Ty kur jeta nuk ka kuptim. Unë të besoj Ty dhe e di se do të bësh gjithçka për të mirën time. Në emër të Jezusit, unë lutem. Amen.”***

Mos harro, ajo që po kalon tani nuk do të zgjasë përgjithmonë. Kur kaloj një kohë të vështirë, më pëlqen ti kujtoj vetes: “Edhe kjo do të kalojë.” Ndërkohë, mund të zgjedhësh të vendosësh besimin tënd te Perëndia dhe ta lejosh që të të japë gëzim në mes të asaj që po kalon.

Gjithashtu është mirë të qëndrosh në Fjalën e Perëndisë dhe të inkurajosh veten me vargje si Isaia 41:10.

Perëndia thotë: *Mos ki frikë [nuk ka asgjë për t'u frikësuar]*

sepse unë jam me ty, mos e humb, sepse unë jam Perëndia yt. Unë të forcoj dhe njëkohësisht **të ndihmoj** dhe të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime.

Çfarëdo që mund të kalosh tani, të inkurajoj të qëndrosh dhe të mos heqësh dorë. Merr një vendim për të mbajtur një qëndrim të mirë dhe vazhdo t'i besosh Perëndisë. Sepse Jezusi është me ty gjatë çdo stuhie dhe ti do të dalësh më i fortë se më parë.

- KAPITULLI 5 -

## Një Fillim i Ri

**Kur je i zhgënjyer dhe ndihesh i pashpresë, të ndihmon jashtëzakonisht shumë të kujtosh se si Zoti të ka ndihmuar ty në të shkuarën.** Gjithashtu është inkurajuese, t'i kujtosh vetes besnikërinë e Tij ndaj të tjerëve, njerëz si ti të cilët kanë pasur nevojë për ndihmën e Perëndisë në mënyrë dëshpëruese.

A i ke vënë re ndonjëherë të gjithë njerëzit në Bibël të cilëve Perëndia u dha një fillim të freskët?

**Moisiu** ishte një burrë i moshuar përpara se të kishte takimin në ferrishten që flakëronte dhe të thirrej nga Perëndia për të udhëhequr një komb. Para kësaj, megjithatë, ai kaloi 40 vjet i fshehur në pjesën e pasme të shkretëtirës! Ai nuk e kishte idenë se çfarë kishte planifikuar Perëndia. (Shih Eksodi 1-4.)

**Davidi**, një djalosh bari i përlur, u vajos si mbret i Izraelit. Ai ishte në thelb një askush nga askund, personi i fundit që dikush do të kishte zgjedhur për të qenë mbret. Por Perëndia e përdori Atë për të udhëhequr popullin e Tij. (Shih1 Samuelit 16.)



**Pjetri**, apostulli i cili mohoi Krishtin, u fal dhe u thirr për të kaluar të gjithë jetën e tij duke predikuar dhe përlëvduar Perëndinë. (Shih Luka 22:54-62; Gjoni 21; Veprat 3.)

Dhe **Pali**, i cili dikur e persekutonte popullin e Perëndisë, u transformua në rrugën për në Damask dhe përfundoi duke shkruar pjesën më të madhe të Dhjatës së Re! (Shih Veprat 9:1-22.)

Kur ti mendon për të gjithë njerëzit e Shkrimit të cilët Perëndia i fal, i shpengoi dhe i përdori në mënyra të fuqishme, mos dysho që ai është i aftë të bëjë të njëjtën gjë për ty.

Perëndia ynë është Perëndia i shpresës. Ai është Perëndia i mundësive të reja, i shanseve të dyta, i fillimeve të freskëta dhe të reja. Ai nuk ka asnjë kufi se sa shumë mund të kesh.

## **SHIKO ME SYTË E SHPRESËS**

Mbaj mend, shpresa është spiranca e shpirtit tonë. Kur gjërat duken të errëta dhe ne nuk kemi një përgjigje, shpresa na kujton që fillimi ynë i ri është shumë afër.

Kur duket sikur të gjithë të tjerët po bekohen, dhe ne jemi të lodhur dhe gati të heqim dorë, është shpresa që na forcon zemrën dhe na mban në besimin tonë në premtimin e Perëndisë.

Përsëri, shpresa është një pritshmëri e favorshme dhe e sigurt. Është një qëndrim pozitiv dhe një pritje e lumtur që diçka e mirë do të ndodhë.

Shpresa e vërtetë nuk është një qëndrim i paqartë dhe i

zbehtë që thotë: “le të presim dhe të shohim se ç’do të ndodhë”, por është besimi dhe siguria se atë që Zoti ka premtuar, do ta bëjë. Zoti thjesht po kërkon mundësinë për t’u bërë mirë fëmijëve të Tij dhe Ai do që ne ta presim me entuziazëm!

Tek 1 Thesalonikasve 5:8, shpresa përshkruhet si një helmetë. Pra, çfarë ne mendojmë duhet të jetë shumë e rëndësishme. Qëndrimi ynë dhe pritshmëria jonë ka të bëjë gjithçka me atë që mendojmë dhe themi!

Unë të inkurajoj që së pari çdo mëngjes të marrësh kontroll mbi mendimet dhe fjalët e tua. Kur zgjohesh në mëngjes, mos lejo mendime si: “Epo mendoj se do ta shtyj ditën edhe sot!”

Në vend të kësaj, parashikoni gjëra të mira nga Perëndia. Mendoni dhe shpallni:

**Perëndi, të falënderoj për këtë ditë! Unë e di që Ti më do dhe që ke një plan të mirë për mua sot. Pa Ty unë nuk mund të bëj asgjë, por në Krishtin unë mund të bëj gjithçka që duhet të bëj. Dhe me ndihmën tënde, unë do të kem një qëndrim të mirë dhe mendime pozitive.**

Më pas prisni kthesën tuaj dhe fillimin e ri. Thuaj, “Sot mund të jetë dita!”

Është shumë e rëndësishme të kuptoni që ne nuk mund të jetojmë sipas ndjenjave tona nëse dëshirojmë të kemi një jetë pozitive, plot shpresë. Kur ndjenjat negative të vijnë, nëse nuk u dorëzohemi atyre dhe nuk i ushqejmë, ato do të vdesin.

Pra, mos e lejoni veten të kapeni në grackën e pritjes për t'u ndjerë me shpresë, por përkundrazi, vendosni të jeni plot shpresë. Kur merrni një vendim të vetëdijshëm për të menduar mendime pozitive dhe të mbushura me besim gjatë gjithë ditës, ndjenjat tuaja do të jenë në përputhje me vendimin tuaj!

## **DIL JASHTË TENDËS TËNDE**

Disa vite më parë, e pyeta Zotin: "Pse nuk kam më gjëra emocionuese, të veçanta në jetën time?" Perëndia i foli zemrës time dhe më tha: "Joyce, unë vazhdoj t'i bëj ato gjëra gjithë kohës. Je ti ajo që je mësuar me këtë mënyrë."

Perëndia dëshiron që ne të jetojmë të mahnitur nga mirësia e Tij në jetën tonë, të marrim parasysht në mënyrë aktive gjërat vërtet të mrekullueshme që Ai bën për ne. Pse? Sepse kur jetojmë të mahnitur, nuk do të jemi kurrë pa shpresë! Le të shohim historinë e Abrahamit.

Perëndia e kishte bekuar Abrahamin me bollëk. Megjithatë, kishte një gjë që ai dhe gruaja e tij, Sara, nuk kishin, një fëmijë. Abrahami tha: ...*O Zot, Zot, çfarë mund të më japësh, sepse unë jam pa fëmijë...?*

*Pastaj [Perëndia] e çoi jashtë [çadrës së tij nën dritën e yjeve] dhe i tha: "Vështro me kujdes qiellin dhe numëro yjet në rast se mund t'i numërosh", pastaj shtoi: "Kështu ka për të qenë pasardhja jote".*

(Zanafilla 15:2, 5)

Megjithëse rrethanat e Abrahamit dukeshin dërrmuese, Zoti e nxori atë nga tenda e tij për ta mahnitur dhe për t'i kujtuar se Ai mund të bëjë të pamundurën.

Unë besoj se ne të gjithë mund të kalojmë më shumë kohë “në tendën tonë”, duke parë problemet tona. Ja pse Bibla na thotë të largohemi nga shpërqendrimet e jetës dhe të përqendrohemi tek Jezusi, autori dhe plotësonjësi i besimit tonë. (Shih Hebrenjve 12:2.)

Sa herë që ne vendosim të lutemi, të lexojmë Fjalën e Tij ose thjesht, të ndalemi në gjërat e mëdha që Ai ka bërë për ne në të shkuarën, prodhohet shpresë. Dhe, si Abrahami, shpejt do të fillojmë të mendojmë: “Uau, ndoshta Ai do ta bëjë këtë për mua!”

Kur kohët janë të vështira dhe ndihesh i dekurajuar, është koha të dalësh nga tenda jote dhe të shohësh se çfarë Perëndia ka për të thënë. Kur ta bësh këtë, do të kuptosh që Ai thjesht po pret të të mahnisë ty.

### **KOMPESIM I DYFISHTË PËR TELASHIN TËND**

Nëse jeni si unë, e keni të lehtë të keni shpresë për dikë tjetër. Nuk më duhet aspak shumë për të parë të mirën dhe për t'i inkurajuar me fjalë të tilla si: “Gjithçka do të funksionojë - thjesht ki besim te Zoti dhe Ai do t'i kthejë gjërat për mirë.”

Por kur bëhet fjalë për ne? Kjo është një histori tjetër! Kur jemi në mes të momentit të dhimbjes ose zhgënjimit, është shumë joshëse t'i dorëzohemi mendimeve të tilla si: “Ka mbaruar. Është shumë vonë për mua.”

Por nuk është shumë vonë! Kurrë nuk është shumë vonë për të pasur një fillim të ri kur ke jetë në Krishtin. E shkuara jote nuk e përcakton të ardhmen tënde. Nëse refuzon të heqësh dorë nga shpresa, dhe e lejon Frymën e Shenjtë të të drejtojë, Perëndia jo vetëm do të restaurojë çfarë

ke pasur, por Ai do ta bëjë jetën tënde edhe më të mirë.

I dua shumë vargjet tek Joeli 2:25-26. Ndërsa e lexon, merre këtë pasazh në zemrën tënde. Pranoje këtë për veten sot.

*kështu do t'ju kompensoj për të korrat që kanë ngrënë karkaleci, larva e karkalecit, bulkthi dhe krimbi, ushtria ime e madhe që kisha dërguar kundër jush. Dhe ju do të hani me bollëk dhe do të ngopeni, dhe do të lëvdoni emrin e Zotit, Perëndisë tuaj, që për ju ka bërë mrekulli, dhe popullin tim nuk do ta mbulojë më turpi.*

Si e rritur, isha e bindur se abuzimi si fëmijë më kishte lënë shenjë përgjithmonë. Ndihesha sikur nuk mund të isha kurrë si gjithë të tjerët ose të kisha jetën që mund të kisha pasur.

Por gjithçka është e mundur me Perëndinë! Aty ku ne shohim rrugë pa krye, Ai sheh një fillim të ri. Ai dëshiron të marri dhimbjen e së shkuarës dhe jo vetëm ta shërojë atë, por Ai dëshiron të na ripërtërijë shumë më tepër se sa do të kishim qenë pa i kaluar ato përvoja!

Shikoni me mua tek Isaia 61:7. Vargu thotë: *Në vend të turpit tuaj do të keni një nderim të dyfishtë; në vend të hutimit do të ngazëllojnë në trashëgiminë e tyre. Prandaj në vendin e tyre do të zotërojnë dyfishin dhe do të kenë një ngazëllim të përjetshëm.*

Unë shpesh them që me Perëndinë, nëse plani A dështon, atëherë ai ka gjithmonë një plan B dhe madje është më i mirë sesa plani A!. Perëndia është Perëndia i restaurimit dhe i fillimeve të reja. Nëse do ta lejosh, Ai do të të japë një fillim të ri, Ai do të të japë dyfishin! Dhe do të jetë shumë më mirë se ç'mund të imagjinosh.

- KAPITULLI 6 -

## **Si Të Shohësh Lart Kur Ndiresh Poshtë**

**Të gjithë ne përjetojmë momente në jetë kur ndihemi të dëshpëruar për arsye të ndryshme, por nuk mund të lejojmë që rrethanat tona të kontrollojnë emocionet tona.**

Satani kërkon të na mbushë mendjen me mendime negative që përfundimisht na bëjnë të humbasim gëzimin dhe të ndihemi të trishtuar. Ai është një dekurajues dhe dëshiron të na rrëzojë emocionalisht, shpirtërisht, financiarisht dhe në çdo mënyrë që mundet.

Por Jezusi është inkurajuesi ynë, dhe Ai erdhi të na ngrrejë lart! Ai erdhi për të na dhënë drejtësim, paqe dhe gëzim. Ai dëshiron që ne të presim gjëra të mira për të ardhmen tonë dhe të mbushemi plot shpresë.

Të gjithë përjetojnë kohë zhgënjimi dhe shqetësimi për plane ose ëndrra të paplotësuara. Kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç shpresojmë, është normale të ndihemi të dekurajuar ose të zhgënjyer.

Por ne duhet të jemi të kujdesshëm se si i trajtojmë këto ndjenja, sepse nëse i mbajmë aty për shumë kohë, mund të na çojnë në depresion.

Psalmi 30:5 na thotë që ... *Të qarat mund të vazhdojnë një natë, por në mëngjes shpërthen një britmë gëzimi.*

Situatat mund të na bëjnë të ndihemi të trishtuar për-kohësisht, por nuk duhet të qëndrojmë të trishtuar. Nëse e bëjmë këtë, armiku përfiton nga dera e hapur dhe e bën rrugën e tij më tej në jetën tonë, duke sjellë probleme më serioze.

Me Zotin, gjithsesi, kur zhgënjehemi, gjithmonë mund të marrim një vendim për ta kapërcyer. Ne mund të zgjedhim të shohim tek Ai një shpresë të re dhe forcë të re për të ecur përpara

### **KUSHTOJI VËMENDJE NDJENJAVE TË TUA**

Nëse ke përjetuar ndonjëherë depresion, ti e di që është shumë real. Ai mund të na bëjë të ndihemi të izoluar, të vetmuar dhe të pashpresë, sikur çdo gjë rrotull nesh po shkatërrohet.

Tani, unë e kuptoj që depresioni mund të jetë rezultat i një mosbalancimi fizik ose kimik, dhe nuk dua t'i zhvlerësoj këto shkaqe. Ka raste kur Zoti do të drejtojë dhe udhëheqë dikë për të shkuar tek një mjek profesionist i aftë ose tek një psikolog që mund ta ndihmojë atë të gjejë rrënjën e problemit. Unë besoj se njohuria mjekësore vjen nga Perëndia dhe se Ai punon përmes doktorëve për të bërë gjëra të mëdha.

Megjithatë, për një numër të madh njerëzish, depresioni është gjithashtu një çështje shpirtërore. Satani përdor depresionin për të vjedhur fuqinë shpirtërore dhe lirinë e një personi. Ai kërkon të na mbushë mendjet me errësirë

dhe mërzi dhe të na shkatërrojë emocionalisht.

Por Perëndia dëshiron të na ndihmojë të jetojmë të lirë nga depresioni. Ai dëshiron të na mbushë me gëzimin e Tij, me shpresë dhe pritshmëri për gjëra të mira për jetën tonë. Në mënyrë që të bashkëpunojmë me Të, një gjë që duhet të bëjmë, është të mësojmë të mos jetojmë sipas ndjenjave tona.

Shpesh kam thënë se emocionet mund të jenë një nga armiqtë tanë më të mëdhenj. Është e lehtë të udhëhiqesh nga mënyra se si ndihesh, por ne duhet të kuptojmë që ndjenjat janë të paqëndrueshme. Ato ndryshojnë nga dita në ditë!

Ne nuk duhet të shkojmë pas çdo mendimi apo pas çdo ndjenje që kemi sepse ato shpesh janë në kundërshti me të vërtetën që Perëndia thotë për ne.

Për shumë vite në jetën time, kam përjetuar depresion të rregullt. Unë zgjohesha në mëngjes me një zë të vogël në kokën time që thoshte, "Ndihem e dëshpëruar." Unë besoja se ky ishte mendimi im, duke mos e kuptuar se armiku po përpiquej t'i fliste gënjeshtër mendjes time.

Më vonë, kur Perëndia më afroi në një ecje më të ngushtë me Të dhe unë fillova të studioja seriozisht Fjalën e Tij, mësova që nuk duhet të ndiqja çdo ndjenjë apo mendim që kisha. Fillova të flas me zë të lartë dhe thoja: "Unë nuk do të jem e dekurajuar apo e dëshpëruar!"

Ne do të kemi gjithmonë ndjenja, ato nuk largohen kurrë. Megjithatë, ne kemi një zgjedhje, nëse do i lejojmë apo jo ndjenjat tona të drejtojnë jetën tonë.



## RISHIKO MENDIMET E TUA

Mendja është një tjetër çelës kryesor për të kapërcyer dekurajimin dhe depresionin. A e dini se ajo për të cilën mendoni ka fuqinë të ndikojë në çdo fushë të jetës suaj?

Fjalët e urta 23:7 thotë, *Sepse [njeriu] si mendon në zemrën e vet, ashtu është ai...*

Mendjet tona janë të fuqishme! Kur zgjedhim të ndalemi tek të gjitha gjërat negative për veten tonë ose gjërat e këqija që na kanë ndodhur, ushqejmë dekurajimin dhe depresionin.

Vite më parë, luftova me kancerin e gjirit, dhe ishte me të vërtetë një kohë sprove për mua. E dija se nëse do ta lejoja mendjen time të kishte mendime negative, së shpejti do të kaloja në depresion.

Gjatë asaj kohe, Perëndia më vendosi në zemër që ta mbushja mendjen time me gjërat e mëposhtme, t'i flisja ato me zë të lartë sa më shpesh që të mundesha. Unë mendoja dhe thoja:

**“Perëndi, unë e di që ti më do. Unë besoj që të gjitha gjërat bashkëveprojnë për të mirën e atyre që të duan Ty dhe janë të thirrur sipas qëllimit Tënd. Unë e vendos besimin tim tek Ti dhe nuk do të kem frikë.”** (Shih Romakëve 8:28, 35-39; Jozueu 1:9; Fjalët e urta 3:5).

E sheh, sa më shumë kohë të kalosh duke lexuar dhe menduar për Fjalën e Tij, aq më shumë hyn brenda teje dhe fillon të të ndryshojë ty nga brenda jashtë.

Hebrenjve 4:12 thotë që Fjala e Perëndisë është e

*gjallë dhe e fuqishme*(NLT). Ajo ka aftësinë të ndryshojë mënyrën se si e sheh veten tënde dhe madje edhe të ardhmen tënde.

Ndërsa e mbush mendjen tënde me atë që Perëndia thotë për ty dhe i shpall premtimet e Tij si të tuat, do të kesh shpresë dhe do të ndërtoosh besimin tënd.

## **NJË PËRSHKRIM BIBLIK PËR DEPRESIONIN**

Siç e përmenda, depresioni ndonjëherë është rezultat i çështjeve fizike dhe kimike dhe unë besoj që është e rëndësishme të lejojmë mjekët të na ndihmojnë ashtu siç Zoti i drejton. Por edhe kur vizitojmë një mjek, unë mendoj se është mirë të sigurohemi nëse e kemi vendosur besimin tonë tek Perëndia, Shëruesi ynë.

Megjithatë, depresioni shumë shpesh është një luftë frymërore dhe Bibla na jep neve udhëzime të shkëlqyera se si ta luftojmë atë.

Isaia 61:3 na thotë të veshim *mantelin e lavdërimit në vend të një frymë të ligështuar...*

Ne mund të mos ndiejmë gjithmonë dëshirën për ta lavdëruar Perëndinë, por nëse marrim pak momente kohë për të biseduar me Zotin dhe ta falënderojmë Atë për mirësinë e Tij është një nga armët më të fuqishme që ne kemi për të luftuar dekurajimin dhe depresionin.

Ne fjalë për fjalë e ftojmë prezencën e Perëndisë në situatën tonë dhe kjo na sjell forcën, paqen dhe gëzimin e Tij. Filipianëve 4:4 thotë, *Gëzohuni gjithnjë në Zotin [kënaquni, gëzohuni në Të]; po jua them përsëri: Gëzohuni!*

Të lavdërojmë Perëndinë në mes të dhimbjes tonë është gjëja më e madhe që ne mund të bëjmë. Pse? Sepse kur në zgjedhim të përqendrojmë vëmendjen tonë tek Perëndia dhe gëzohemi në gjërat e mira që Ai ka bërë, ne e bëjmë Atë më të madh se sa problemet tona.

E vërteta është se, Perëndia është gjithmonë i mirë, pavarësisht se çfarë po ndodh në jetët tona. Ai është Burimi i gëzimit tonë, dhe ne mund të vrapojmë tek ai për çlirim në çdo kohë që kemi nevojë.

*Kjo më çon mua tek Psalmi 16:11. Ai thotë: ...ka plot gëzim në praninë tënde; në të djathtën tënde ka kënaqësi në përjetësi.*

Kur ne adhurojmë Perëndinë, ne e ftojmë praninë e Tij në jetën tonë. Ai zëvendëson dekurajimin dhe trishtimin tonë me gëzimin dhe paqen e Tij, duke na dhënë shpresë dhe frymëmarrje të re për situatën tonë.

Ne nuk mund të ndryshojmë gjithmonë gjithçka që ndodh përreth nesh, por prania e Perëndisë do të na ndryshojë ne, mënyrën si mendojmë, si ndihemi, dhe si e shohim situatën tonë.

### **JEPJA PERËNDISË DHEMBJEN TËNDE.**

Ne nuk do të jemi kurrë plotësisht të lirë nga përjetimi i dhembjes apo zhgënjimit, por ne nuk duhet të lëmë atë që na ndodh sot të na prishë të nesërmen.

Ne kemi një zgjedhje. Ne në fakt mund t'i kthejmë gjërat duke marrë një vendim për të hequr dorë nga situatat që na shkaktuan dekurajim dhe depresion dhe të shkojmë drejt gjërave të mira që Perëndia ka planifikuar për të ardhmen tonë.

Unë e dua shumë vargun tek 1 Pjetrit 5:9, që thotë: *atij kundërshtojini [djallit]...[kundër sulmit të tij]...* Është shumë e rëndësishme t'i rezistojmë ndjenjave të dekurajimit dhe depresionit menjëherë, sepse sa më gjatë t'i lejojmë ato të qëndrojnë, aq më i vështirë bëhet rezistimi kundër tyre!

Unë e them këtë prej vitesh: nëse nuk e lejon Satanin të të bëjë përshtypje me dredhitë e tij, ai nuk do të jetë në gjendje të të shtypë; dhe nëse nuk mund të të shtypë, as nuk mund të të dëshpërojë.

Herën tjetër kur të përballësh me një situatë që kërcënon të të rrëzojë poshtë, vendos të kthehesh tek Fryma e Shenjtë dhe lejoje Atë të të mbushë me shpresë. Zgjidh të besosh atë që Perëndia thotë në vend që të besosh ndjenjat e tua. Mbushe mendjen tënde dhe gojën tënde me gjëra pozitive, plot shpresë nga Fjala e Perëndisë.

Ti nuk duhet të lejosh që dekurajimi dhe depresioni të sundojnë jetën tënde. Kur "gjërat ndodhin", lëreni Perëndinë e çdo shprese tju forcojë dhe inkurajojë nga brenda.

Sepse pavarësisht se çfarë je duke kaluar, Perëndia është gati të marrë dhembjen tënde dhe *ta kthejë atë në diçka madhështore.*

## KONKLUZION

# A Je Duke Kaluar një Kohë të Vështirë?

**Nëse je duke kaluar një kohë të vështirë në këto momente, unë dëshiroj që ti të dish se Perëndia të do ty.** Ai e sheh se çfarë je duke kaluar, Ai është me ty, dhe dëshiron të të ndihmojë aty ku ti je.

*Psalmi 34:18 thotë: Zoti qëndron afër atyre që e kanë zemrën të thyer dhe shpëton ata që e kanë frymën të dërrmuar.* Kur jemi në dhembje, Perëndia e ndjen dhembjen tonë gjithashtu.

Tani për tani, ti mund të jesh duke u përballur me një situatë që duket e pamundur. Por unë dua që të dish se Perëndia mund t'i bëjë të gjitha gjërat të reja. Ai mund ta marrë problemin tënd dhe ta kthejë atë në diçka të mirë.

Nëse po përballesh me vështirësi ose me diçka kërcënuese, të inkurajoj të marrësh pak momente dhe të lutesh pikërisht tani:

**O At', kam nevojë për ty tani. Ti thua që më do dhe e sheh saktësisht se ku jam, dhe pavarësisht se çfarë ndjej unë tani, unë zgjedh të besoj Fjalën Tënde. Përballë gjithë asaj që po kaloj, kërkoj nga Ti për ndihmë. Unë kam nevojë për forcën Tënde për t'u**

**marrë me gjithçka që duket shumë e madhe për mua tani. Më ndihmo të mbaj sytë nga Ti. Të lutem bëhu i vërtetë për mua...dhe më inkurajo për rrugën që kam përpara. Më ndihmo të përjetoj dashurinë dhe praninë Tënde në një mënyrë të prekshme. Unë të jap Ty gjithçka që jam. Në emër të Jezusit, amen.**

Të inkurajoj gjithashtu që të marrësh pak kohë dhe të lexosh vargjet e mëposhtme. Mund të them nga përvoja se Fjala e Perëndisë do të ndryshojë jetën tënde, mënyrën se si mendon, si ndihesh dhe madje edhe se si e sheh të ardhmen tënde.

E dua shumë vargun tek Jeremia 29:11. Ai thotë se Perëndia ka një plan të mirë për të ardhmen tënde, një plan paqeje, plane që sjellin shpresë.

Gjithmonë kujto që Perëndia është në anën tënde. Ai është Perëndia i të pamundurës dhe Ai që mund të bëjë mrekulli në çdo situatë.

### **ZOTI TË DO TY.**

*“Shumë kohë më parë Zoti m’u shfaq duke thënë: «Po, të kam dashur me një dashuri të përjetshme; prandaj të kam tërhequr me dashamirësi.”*

### **Jeremia 31:3**

*Edhe sikur malet të zhvendoseshin dhe kodrat të luanin nga vendi, dashuria ime nuk do të largohet prej teje, as besëlidhja e paqes nuk do të hiqet, thotë Zoti, që ka dhembshuri për ty.*

### **Isaia 54:10**

*Ti i ke numëruar hapat e bredhjes sime; vendosi lotët e mi në calikun tënd; a nuk i ke regjistruar në librin tënd?*

**Psalmi 56:8**

*Para se unë të të formoja në barkun e nënës sate, të kam njohur; para se ti të dilje nga barku i saj, të kam shenjtëruar dhe të kam caktuar profet të kombeve*

**Jeremia 1:5**

## **ZOTI ËSHTË NDIHMA JOTE.**

*“Mos ki frikë, sepse unë jam me ty, mos e humb, sepse unë jam Perëndia yt. Unë të forcoj dhe njëkohësisht të ndihmoj dhe të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime.”*

**Isaia 41:10**

*Edhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asnjë e keqe, sepse ti je me mua; shkopi yt dhe kërraba jote janë ato që më japin zemër*

**Psalmi 23:4**

*Unë e kërkova Zotin, dhe ai m’u përgjigj dhe më çliroi nga të gjitha tmerret e mia.*

**Psalmi 34:4**

*Kur të kalosh përmes ujërave, unë do të jem me ty, ose të kalosh lumenjtë, nuk do të të mbytin; kur të ecësh nëpër zjarr, nuk do të digjesh dhe flaka nuk do të të përpijë.*

**Isaia 43:2**

## ZOTI ËSHTË SHPRESA JOTE.

*Sepse unë i njoh mendimet që kam për ju, thotë Zoti, mendime paqeje dhe jo të së keqes, për t'ju dhënë një të ardhme dhe një shpresë.*

**Jeremia 29:11**

*Sjellja juaj të jetë pa lakmi paraje dhe kënaquni me atë që keni, sepse vetë Perëndia ka thënë: "Nuk do të të lë, as nuk do të të braktis."*

**Hebrenjve 13:5**

*Sepse te Perëndia asgjë s'është e pamundshme.*

**Luka 1:37**

*Hidh mbi Zotin barrën tënde dhe ai do të të mbajë; ai nuk do të lejojë kurrë që i drejti të lëkundet*

**Psalmi 55:22**

*Kur të kem frikë, do të mbështetem te ti.*

**Psalmi 56:3**

## ZOTI ËSHTË NGUSHËLLIMI DHE FORCA JOTE.

*Ai shëron ata që e kanë zemrën të thyer dhe lidh plagët e tyre.*

**Psalmi 147:3**

*Ai i jep forcë të lodhurit dhe rrit fuqinë e të këputurit.... por ata që shpresojnë te Zoti fitojnë forca të reja, ngrihen me krahë si shqiponja, vrapojnë pa u lodhur dhe ecin pa u lodhur.*

**Isaia 40:29, 31**



*Ejani tek unë, o të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t'ju çlodh.*

**Mateu 11:28**

*Perëndia është për ne një strehë dhe një forcë, një ndihmë gjithnjë e gatshme në fatkeqësi.*

**Psalmi 46:1**

# Lutja e Shpëtimit

**Zoti të do dhe dëshiron që të ketë një marrëdhënie personale me ty!** Nëse ende nuk e ke pranuar Jezus Krishtin si shpëtimtarin tënd, mund ta bësh në këtë moment! Thjesht hapja zemrën tënde atij dhe thuaj këtë lutje:

*“Atë, e di që kam mëkatuar ndaj Teje. Të lutem më fal. Më bëj të pastër. Unë të premtoj se do t’i besoj Jezusit, Birit Tënd. Unë besoj se Ai vdiq për mua. Ai mori mëkatim tim mbi vete, kur Ai vdiq në kryq. Unë besoj se ai është ringjallur prej të vdekurve. Unë ja dorëzoj jetën time Jezusit , në këtë moment. Faleminderit Atë, për dhuratën tënde të faljes dhe të jetës së përgjeshme. Të lutem, më ndihmo të jetoj për Ty! Në emër të Jezusit, Amen!”*

Nëse ti lutesh me vërtetësi në zemrën tënde, Zoti të ka dëgjuar, të ka pastruar dhe të ka çliruar nga skllavëria e vdekjes shpirtërore. Merr një kohë për ti lexuar dhe studiuar këto vargje dhe kërkoji Zotit që të të flasë, ndërkohë që ti ecën me Të, përmes këtij udhëtimit të jetës tënde të re.

Gjoni 3:16

1 Korintasve 15:3-4

Efesianëve 1:4

Efesianëve 2:8-9

1 Gjonit 1:9

1 Gjonit 4:14-15

1 Gjonit 5:1

1 Gjonit 5:12-13

Lutju Atij dhe kërkoji të të drejtojë në një kishë, e cila bazohet fort mbi biblën. Kështu, ti do të kesh mundësinë që të rrites në marrëdhënien tënde personale me Jezus Krishtin. Zoti është gjithmonë me ty. Ai do të drejtojë ty ditë pas dite dhe do të tregojë sesi të jetosh jetën plot bollëk, që Ai ka rezervuar për ty.

*Nëse je gati të fillosh udhëtimin tënd personal me Jezusin, ose ndoshta dëshiron ta njohësh Atë në mënyrë më të thellë, vizito:*

<https://tv.joycemeyer.org/shqip>

## RRETH AUTORES

Joyce Meyer është autorja me shitjet më të mira të New York Times dhe një nga mësueset kryesuese të Biblës në botë. Përmes *Joyce Meyer Ministries*, ajo mëson praktikisht dhe sinqerisht, duke ndarë hapur përvojat e saj dhe duke ndihmuar miliona njerëz që të zbatojnë parimet biblike në situatat e tyre dhe në fund të gjejnë shpresë dhe ripërtëritje nëpërmjet Jezus Krishtit. Libri i saj *Fushëbeteja e Mendjes* është bërë një bestseller i përjetshëm, duke u mësuar njerëzve se si të fitojnë betejën në mendjet e tyre dhe "të mendojnë për atë që po mendojnë". Joyce ka mbajtur konferenca në të gjithë Shtetet e Bashkuara dhe në mbarë botën, dhe programi i saj *Shijoje Jetën Çdo Ditë* transmetohet në TV, radio dhe në internet për miliona njerëz në mbi 100 gjuhë. Ajo ka shkruar gjithashtu mbi 130 libra, të cilët janë përkthyer në mbi 155 gjuhë

# JOYCE MEYER MINISTRIES

## Tregojmë Krishtin—Duam Njerëzit

*Joyce Meyer Ministries* është thirrur të ndajë Ungjillin, të dishepullizojë kombet dhe të përhapë dashurinë e Krishtit.

Përmes medias ne i mësojmë njerëzit si të zbatojnë të vërtetën biblike në çdo aspekt të jetës së tyre dhe inkurajojmë popullin e Perëndisë të shërbejnë në botën që i rrethon. Përmes krahut tonë të misionit, *Hand of Hope*, ne sigurojmë ndihma humanitare në të gjithë globin, ushqejmë të uriturit, veshim të varfrit, i shërbejmë të moshuarve, vejushave dhe jetimëve, dhe arrijmë njerëzit e të gjitha moshave, në të gjitha sferat e jetës.

*Joyce Meyer Ministries* është ndërtuar mbi një themel besimi, integriteti dhe mbështetës të përkushtuar që ndajnë këtë thirrje.

\* \* \*

Për të marrë inkurajim shtesë nga *Joyce Meyer Ministries*, ju lutemi vizitoni:

<https://tv.joycemeyer.org/shqip>